



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 5707 Prot.

Vau Dejes me 18.09.2024

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funksonimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Koman, Njesia Administrative Temal të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

**Projekt vendim për miratimin e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A Temal, Bashkia Vau Dejës.**

(Paraqitur nga Drejtoria planifikimit territorit,kadastres dhe investimeve publike)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **17.10.2024 ora 10.30 fshati Koman**, Njësia Administrative Temal.

Gjithashtu ju ftojme të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm,nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike deri me datë 17.10.2024.

([info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al) , [ardian.celepija@vaudejes.gov.al](mailto:ardian.celepija@vaudejes.gov.al), facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Ardian CELEPIJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, KADASTRES DHE  
INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 5567 prot.

Vau Dejës, më 13.09.2024

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**  
**Z. Ervis Shimaj. KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Të nderuar,**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin për:

**Pe miratimin e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia  
Vau Dejës .**

Me respekt,

**KRYETARI**  
**KRISTIAN SHKRELI**

**Konc: Dorina Lekaj (juriste)**



Datë: \_\_\_\_\_

Nr.i faqeve A4 të projekt-vendimit: \_\_\_\_\_

Nr.i fletëve të dokumentëve që shoqërojnë projekt-vendimin: \_\_\_\_\_





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, KADASTRES DHE  
INVESTIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vau Dejës, me: 13.09. 2024

**Projekt – Vendim**  
**Nr. 5 Date : 13/09/2024**

**Pe miratimin e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia  
Vau Dejës .**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar, Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, Ligjit nr 107/2014 “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin Të Territorit” i ndryshuar, Ligji 9632 date 30.10.2006 i ndryshuar, VKM nr 1096 date 28.12.2015 “ Per miratimin e rregullave dhe Proçedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike, VKB Nr. 71. Date 26.11.2020 “ Per Miratimin e Paketës Fiskale Bashkia Vau Dejes , ndryshuar, Ne zbatim të nenit 7 të *LIGJ Nr.8378, datë 22.7.1998 KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË*, ndryshuar (Rregullimi i qarkullimit në qendrat e banuara), si dhe në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 404 date 07.06.2024 me Prot 3669/1 “Per ngritjen e grupit të punës për verifikimin e problematikes dhe disiplinimin e parkingjeve publike në Nj.A. Temal, si dhe në Relacionin e paraqitur nga grupi I Punes me Nr. 3669/2 Prot date 14.06.2024. Si dhe në zbatim të shkresës së Prefektit të Qarkut Shkoder, Prot. 531/1 date 12.08.2024, Lenda : Mbi vendimin Nr. 54, date 29.07.2024 të KB Vau Dejes.

**PROPOZOJME**

1. Këshillit Bashkiak Vau Dejes të miratojë këtë projekt vendim për hapjes e disa vend parkimeve në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës.
  2. Këshilli Bashkiak Vau Dejes të miratojë vendin dhe planimetritë sipas hartës bashkëlidhur këtij propozimi dhe sipas projekteve të hartuara nga grupi punës në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 404 date 07.06.2024 me Prot 3669/1 “Per ngritjen e grupit të punës për verifikimin e problematikes dhe disiplinimin e parkingjeve publike në Nj.A. Temal bashkëlidhur këtij projekt vendimi.
  3. Këshilli Bashkiak Vau Dejes të miratojë mënyrën e menaxhimit të vendparkimeve duke nderthurur mënyra të ndryshme si me poshte:
    - Parking publik pa pagesë.
    - Parking publik sezonal me bileta.
    - Parking publik me kontratë vjetore për subjekte apo biznese të interesuar.
- Vëndparkimet publike pa pagesë do të menxhohen nga Njesia Administartive përkatëse në Bashkëpunim me Bashkinë Vau Dejës.
- Vëndparkimet publike sezonale me bilete do të menxhohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike

- Vendparkimet publike me kontratë vjetore i nënshtrohen procedurës së përcaktuar nga neni 8 e në vijim i VKB Nr. 41 datë 27.06.2022 "Rregulloren e Brëndshme për shfrytëzimin e hapësirave publike",
- Strukturat të cilat do të procedojnë për menaxhimin e vendparkimeve do të orientohen sipas rregullave të parashikuara në ligj nr.8378, datë 22.7.1998 kodi rrugor i republikës së shqipërisë, ndryshuar

Ky propozim për ndryshim vjen si nevojë urgjente për ndërhyrje kryesisht në Nj.A. Temal, fshati Koman me qëllim menaxhimin sa më efikas të fluksit turistik gjatë sezonit veror por edhe gjatë gjithë vitit.

Gjithashtu, jo vetëm për trafikun që sjell turizmi por që tu japë mundësi bizneseve që janë të interesuar për vendparkime të personalizuar, si dhe banorëve të zonës të cilët jetojnë dhe po kthehen për të investuar në vendin e tyre.

Për zbatimin e këtij vendimi do të jenë të ngarkuara: Drejtoria e Planifikimit të Territorit Dhe Investimeve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Policia Bashkiake.

Juriste: Dorina Lekaj  
Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike

Drejtor: Ana Shurdha  
Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike

Drejtor: Marinela Deda  
Drejtoria Juridike, Sektori Ligjor, i Kontratave dhe Qeshtjeve Gjyqësore



**KRYETARI  
KRISTIAN SHKRELI**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, KADASTRES DHE  
INVESTIMEVE PUBLIKE

Vau Dejës, më 13.09, 2024

Nr. — prot.

Lenda: **Relacion sqarues lidhur me Projekt Propozimin Per miratimin e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës .**

Në mbështetje të ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ndryshuar. Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", Ligjit nr 107/2014 "Për Planifikimin Dhe Zhvillimin Të Territorit" i ndryshuar. Ligji 9632 date 30.10.2006 i ndryshuar. VKM nr 1096 date 28.12.2015 " Per miratimin e rregullave dhe Proçedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike, VKB Nr. 71. Date 26.11.2020 " Per Miratimin e Paketës Fiskale Bashkia Vau Dejës , ndryshuar, Ne zbatim të nenit 7 të *LIGJ Nr.8378, datë 22.7.1998 KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË*, ndryshuar (Rregullimi i qarkullimit në qendrat e banuara), si dhe ne zbatim të Urdherit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 404 date 07.06.2024 me Prot 3669/1 "Per ngritjen e grupit të punes për verifikimin e problematikes dhe disiplinimin e parkingjeve publike në Nj.A. Temal, si dhe ne Relacionin e paraqitur nga grupi I Punes me Nr. 3669/2 Prot date 14.06.2024 është vlerësuar e domosdoshme që ne fshatin Koman , **Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës te hapen disa vend parkime te reja sipas projektit dhe relacionit te pergatitur nga grupi i punes.**

Ky propozim për ndryshim vjen si nevojë urgjente për ndërhyrje kryesisht në Nj.A. Temal, fshati Koman me qëllim menaxhimin sa me efikas të fluksit turistik gjatë sezonit veror por edhe gjatë gjithë vitit. , jo vetëm për trafikun që sjell turizmi por që tu japë mundësi bizneseve që janë të interesuar për vendparkime të personalizuar , si dhe banoreve të zonës të cilët jetojnë dhe po kthehen për të investuar në vendin e tyre.

Per kete proces do te procedohet sipas rregullave te meposhtme.

- Parking publik pa pagesë.
  - Parking publik sezonal me bileta.
  - Parking publik me kontrate vjetore për subjekte apo biznese të interesuar.
- 
- Vëndparkimet publike pa pagesë do të menxhohen nga Njesia Administrative përkatëse në Bashkëpunim me Bashkinë Vau Dejës.
  - Vëndparkimet publike sezonale me bilete do të menxhohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike
  - Vëndparkimet publike me kontratë vjetore i nënshtrohen procedurës së përcaktuar nga neni 8 e në vijim i VKB Nr. 41 date 27.06.2022 "Rregulloren e Brëndshme për shfrytëzimin e hapësirave publike .,

Juriste: Dorina Lekaj

Drejtoria e Planifikimit Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike